



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 01/99


Datë: 01.07.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 1 korrik 2016, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Projektligji për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit Nr. 05/L-071 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 02/99

Datë: 01.07.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 1 korrik 2016, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Themelohet Komisioni për hartimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-178 për Klasifikimin e Informacioneve dhe verifikimin e sigurisë (tutje: Komisioni) në këtë përbërje:
  - 1.1. Këshilltar i Kryeministrit, Kryesues;
  - 1.2. Këshilltar i Zëvendëskryeministrit, anëtar;
  - 1.3. Zyra e Kryeministrit, ZL, SKQ dhe ZPS, anëtar;
  - 1.4. Agjencia e Kosovës për Inteligjencë, anëtar;
  - 1.5. Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës, anëtar;
  - 1.6. Ministria e Punëve të Brendshme, anëtar;
  - 1.7. Ministria e Drejtësisë, anëtar;
  - 1.8. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, anëtar;
  - 1.9. Ministria e Integritimit Evropian, anëtar;
  - 1.10. Këshilli i Sigurisë se Kosovës, anëtar;
  - 1.11. Policia e Kosovës, anëtar;
  - 1.12. Agjencia Shtetërore e Arkivave, anëtar;
  - 1.13. Ministria e Financave, anëtar.
  
2. Ftohen ta dërgojnë nga një përfaqësues:
  - 2.1. Kuvendi i Republikës së Kosovës;
  - 2.2. Zyra e Presidentit të Republikës së Kosovës;
  - 2.3. Këshilli Prokurorial, anëtar;
  - 2.4. Këshilli Gjyqësor, anëtar.

3. Me pajtimin e Kryesuesit të Komisionit mund të ftohen edhe përfaqësues të Organizatave ndërkombëtare dhe organizata të Shoqërisë Civile si dhe persona tjerë.
4. Me qëllim të kryerjes efikase të aktivitetit të tij, Komisioni mund të formojë grupe punuese të përkohshme si dhe mund të angazhojë ekspert nga fusha e Klasifikimit të Informacioneve dhe verifikimit të Sigurisë.
5. Në punën e tij, Komisioni mund të shfrytëzoj mbështetjen profesionale të institucioneve dhe organizatave përkatëse vendore dhe ndërkombëtare.
6. Komisioni është i obliguar që për punën e tij t'i raportoj Qeverisë kurdo që kërkohet raport për ecurinë e punës së Komisionit.
7. Komisioni është i obliguar që Zyrës së Kryeministrit të ja paraqes Projektligjin më së voni në afat prej dy muaj nga dita e nënshkrimit të këtij Vendimi.
8. Zyra e Kryeministrit obligohet për sigurimin e kushteve materiale, teknike dhe kushteve tjera për punën e këtij Komisioni.
9. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Isa MUSTAFA**

  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 03/99

Datë: 01.07.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 7 paragrafi 5. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 1 korrik 2016, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet propozimi i Ministrisë së Financave për t'i rekomanduar Presidentit të Republikës së Kosovës nga Qeveria e Republikës së Kosovës për autorizimin e Ministrit të Financave për nënshkrimin e Marrëveshjes për Protokollin Financiar në mes të Qeverisë së Republikës së Francës dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës.
2. I rekomandohet Presidentit të Republikës së Kosovës për dhënien e autorizimit për nënshkrimin e marrëveshjes nga pika 1. i këtij vendimi, në pajtim me afatin e përcaktuar në nenin 7 të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Isa MUSTAFA**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 04/99

Datë: 01.07.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4 paragrafi 2. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 1 korrik 2016, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Nisma për lidhjen e Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të Republikës së Kosovës dhe Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, në Prishtinë, për zhvillimin e Programit Fulbright.
2. Përgjatë negociimit të këtij Memorandumi, obligohet Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë të procedoj konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe dispozitave tjera në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi në datën e nënshkrimit.

**Isa MUSTAFA**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 05/99

Datë: 01.07.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 7 paragrafi 5. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 1 korrik 2016, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet propozimi i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për t'i rekomanduar Presidentit të Republikës së Kosovës nga Qeveria e Republikës së Kosovës për autorizimin e Ministrit të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për nënshkrimin e Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të Republikës së Kosovës dhe Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, në Prishtinë, për zhvillimin e Programit Fulbright.
2. I rekomandohet Presidentit të Republikës së Kosovës për dhënien e autorizimit për nënshkrimin e Memorandumit nga paragrafi 1. i këtij vendimi, konform afatit të përcaktuar në nenin 7 të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare.
3. Ky vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**Isa MUSTAFA**

  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 06/99

Datë: 01.07.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, bazuar në kërkesën e Ministrisë së Punëve të Jashtme, me nr. prot. 1478, datë 29.06.2016, në mbledhjen e mbajtur më 1 korrik 2016, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Punëve të Jashtme për ndarjen e mjeteve financiare në vlerë prej 25, 000.00 (njëzetepesëmijë euro).
2. Mjetet financiare nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga Rezerva e Qeverisë Shpenzimet e Paparashikuar, nën-programi Shpenzimet e Paparashikuar me kod 13100 nga kategoria e rezervës dhe transferohen në Ministrinë e Punëve të Brendshme, nën-programi Agjencioni Regjistrimit Civil me kod 14800 në kategorinë ekonomike shpenzime kapitale për projektin: "Krijimi i Regjistrimit Unik dhe Qendror për përdorim të autoriteteve kompetente". Projekti derivon nga aprovimi i Ligjit për ratifikimin e Konventës për heqjen e kërkesës për legalizimin e dokumenteve zyrtare të huaja. Implementimin fillon nga data 14 korrik 2016.
3. Obligohet Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Financave dhe Ministria e Punëve të Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Isa MUSTAFA**

  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë